



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	ENTI SHTETEROR I FARERAVE DHE FIDANEVE
Adresa: Kodër-Kamëz, Tiranë, Albania	Adresa: Rruga "Siri Kodra"
Tel/ Fax +355 200 890 205	Cel.0685295533

Nr. 125 Prot
Tiranë më, 15/01 / 2025

Nr. 28 Prot
Tiranë më, 15/01 / 2025

AKT – MARRËVESHJE

Sot me datë 15.01.2025 lidhet kjo Akt- Marrëveshje midis:

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TE TIRANËS, me adresë Kodër-Kamëz, Rruga Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz-Tiranë, Albania përfaqesuar nga Z.Edmond Tërthorja dhe ENTIT SHTETEROR TE FARERAVE DHE FIDANEVE, Rruga 'Siri Kodra' përfaqesuar nga Znj.Luiza SALLAKU për mënyrën e pagesës së energjisë elektrike.

Neni 1

Baza Ligjore

Rruga Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz-Tiranë; Tel: (+355) 47200 869, Fax: (+355) 47200 874
Website: www.ubt.edu.al



Ligji “Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, “Statutin e Universitetit Bujqësor Tiranë”, miratuar më 28.03.2017 me mbledhje Senati, si dhe Ligje dhe akte nënligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Kjo Akt-Marrëveshje ka për objekt përcaktimin e mënyrës së pagesës të faturave të energjisë elektrike për godinën e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidaneve, ku Universiteti i Bujqësori Tiranës (IRRGJB) ose Banka Gjenetike, kryen aktivitetin e saj brenda godinës së ESHFF.

Në këto kushte kur IRRGJB, nuk ka sahat elektrik më vete dhe që nga viti 2006, është krye pagesa e fatuara të energjisë vetëm nga ESHFF.

Në këto kushte palet bien dakort:

(IRRGJB do të paguaj faturat e 6 muajve të parë të vitit (Janar- Qershor 2025) në bazë të faturave që i vijnë ESHFF, kurse ESHFF do të paguaj faturat e 6 muajve të tjerë (Korrik- Dhjetor 2025)

Nr. Kontratës së energjisë është D 10057 dhe nr. Matesit 0708017331 (Kontratë e ESHFF)

Likujdimi do të bëhet për llogari të FSHU-s me nr. NIPT –i L 81530016 L

Bankën Raiffeisen, nr. llogarise `0051446514

IBAN-i AL 56 2021 1006 0000 0000 5144 6514

Cdo kamat -vnese për periudhë Janar-Qershor 2025, do të paguhet nga (IRRGJB)

Një kopje e Urdhër –Shpenzimit pasi të likujdohet nga UBTiranës do të dërgohet ESHFF.

Kontakti do të jetë përgjegjësja e sek. Finances Aferdita Pici, nr. Cel. 0685295533

e-mail : Aferdita.Pici@eshff.gov.al



Neni 3

Informim i Përfaqësuesve të Palëve

Secila palë me kërkesën e njëjës prej tyre, mund të propozojë ndryshimet në këtë marrëveshje, në çdo rast njoftimi për ndryshimin duhet bërë 15 ditë më parë me shkrim dhe në adresën përkatëse të palës. Asnjë ndryshim nuk do të jetë efektiv dhe nuk do ketë pasoja nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 4

Përfaqësimet

Të dyja palët përfaqësojnë dhe garantojnë njëra-tjetrën vazhdimisht gjatëkohës së zbatimit të Akt-marrëveshjes se ato kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të lidhur dhe për të zbatuar këtë Aktmarrëveshje. Zbatimi i kësaj Akt-marrëveshjeje nuk do të bjerë ndesh, nuk do të shkelë osen uk do të dëmtojë asnjë kontratë, marrëveshje, gjykim, statut, urdhëresë apo rregullore që mund të jetë detyrue se për njëjërën nga palët.

Neni 5

Dispozitat e fundit

Kjo Akt-Marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobitë punës e në referencë të plotë të zbatimi të akte vete tjera ligjore dhe nën ligjore në zbatim të tij. Me propozimin e se cilës palë, ajo do të interpretohet sipas legjislacionit në fuqi.

Aktmarrëveshja u hartua në katër kopje identike të cilat u nënshkruan me vullnetin e lire nga të dy palët.

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës **Për Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve**

Administratori

Z. Edmond Tërthorja



Drejtor

Znj. Luiza SALLAKU





Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

AGJENCIA KOMBËTARE E
KONTROLLIT TË *CANNABIS-IT*

Nr. 17 prot. Tiranë, më 14.7.2025



UNIVERSITETI BUJQËSOR I
TIRANËS

Nr. 89 prot. Tiranë, më 14.01.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË *CANNABIS-IT*

DHE

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Sot, në Tiranë, më datë 14 . 9 .2025, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis palëve:

Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, me adresë Rruga “Ibrahim Rugova”, Pallati Sky Tower, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, Prof. Ass. Linda PUSTINA, këtu e në vijim “*Agjencia*”

dhe

Universitetit Bujqësor të Tiranës, me adresë “Kodër-Kamzë”, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU, këtu e në vijim “*UBT*”

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale, konkretisht, ligjin nr.61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të udhëhequra nga vullneti për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe akademike për realizimin e objektivave strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm, dhe për të nxitur shkëmbimin e ekspertizës, burimeve dhe përvojave në funksion të realizimit të qëllimeve të përbashkëta dhe avancimit të njohurive shkencore në fushën e kontrollit, kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it*,

Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, këtu e në vijim “*Marrëveshja*”.

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit ndër-institucional midis Agjencisë dhe UBT me qëllim ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm, duke kombinuar ekspertizën akademike dhe atë praktike, si dhe të kërkimeve të ndryshme shkencore, në fushën e kontrollit, kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it*.

Neni 2 **Objekti**

1. Përmes kësaj Marrëveshjeje, Palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë për çështje që lidhen me:
 - Hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore;
 - Ofrimin e këshillimeve teknike dhe shkencore;
 - Organizimin e aktiviteteve mësimore, trajnimeve dhe konferencave;
 - Çdo lloj veprimtarie apo aktiviteti tjetër me interes të përbashkët, në zbatim të kompetencave të përcaktuara në **Ligjin nr. 61/2023** dhe **Ligjin nr. 80/2015**.
2. Marrëveshja synon të lehtësojë bashkëpunimin në funksion të përmirësimit të cilësisë, standardeve dhe kontrollit të bimës së *cannabis-it*, si dhe të nxisë kërkimin shkencor në fushën e bujqësisë e bioteknologjisë.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, do të përqendrohet kryesisht në realizimin e veprimtarive të mëposhtme:

1. Këshillim, përmirësimin, mbështetje në hartimin e strategjive, manualeve apo udhëzimeve, si dhe aspekte teknike mbi rregulloret në fushën e kontrollit, kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.
2. Studime mbi përmirësimin e teknikave të kultivimit dhe përpunimit të *cannabis*-it industrial dhe mjekësor.
3. Dhënien e kontributit në hartimin dhe përditësimin e standardeve kombëtare për cilësinë dhe sigurinë e bimës së *cannabis*-it.
4. Bashkëpunime specifike në lidhje me zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimin e ideve inovative, si dhe vendosjen e tyre në praktikë.
5. Forcimi i bashkëpunimit akademik për hartimin dhe zbatimin e kurrikulave mësimore, në të gjitha ciklet e studimit.
6. Shkëmbimin e njohurive për zbatimin e praktikave të mira bujqësore dhe laboratorike (GACP dhe GLP).
7. Asistencën teknike në implementimin e teknologjive të reja për prodhimin e qëndrueshëm të *cannabis*-it dhe monitorimin e proceseve.
8. Shkëmbimin e ekspertizës për zbatimin e metodave shkencore dhe inovative për mbikëqyrjen e ndikimeve mjedisore të kultivimit të *cannabis*-it, si dhe monitorimin e zbatimit të ligjit.
9. Trajnimin e punonjësve të Agjencisë pranë UBT-së me qëllim sigurimiin e njohurive dhe aftësive praktike për marrjen e mostrave të *cannabis*-it, duke përmbushur standardet e kërkuara për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë, si dhe aspekte të tjera teknike në lidhje me testimet laboratorike apo aspekte të tjera që mund të zbatohen gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes.
10. Vendosjen në dispozicion të laboratoreve të UBT-së për kryerjen e studimeve shkencore të përbashkëta apo në kuadër të projekteve, si dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së aplikimeve për përfitimin e granteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
11. Publikimin e rezultateve shkencore dhe studimeve të kryera në revista ndërkombëtare.
12. Bashkëpunimin në kuadër të zhvillimit të temave të diplomës për ciklin 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve apo për mbrojtjen e titujve akademikë.
13. Organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave për integrimin e standardeve ndërkombëtare në legjislacionin kombëtar.
14. Organizimin e konferencave, leksioneve të hapura apo veprimtarive të tjera mbi çështje me interes të përbashkët.

Neni 4

Detyrimet e Palëve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje:

1.1 Agjencia:

- a) Ofron mbështetje për zhvillimin e kurrikulave mbi aspektet ligjore, teknike, kontrollin e cilësisë në lidhje me bimën, nënproduktet dhe produktete *cannabis*-it, standardet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.
- b) Vendos në dispozicion ekspertizën në fushën e monitorimit të ligjit, zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe informacionet në fushën e kultivimit, prodhimit të produkteve dhe nënprodukteve të *Cannabis*-it, zbatimin e standardeve ndërkombëtare, si dhe përparimet në këtë sektor në lidhje me teknologjinë dhe zgjidhjet inovative.
- c) Vendos në dispozicion informacionin e nevojshëm për realizimin e projekteve kërkimore dhe zhvillimore për të avancuar kuptimin shkencor dhe aplikimet praktike të *cannabis*-it, brenda hapësirës që i lejon kuadri ligjor në fuqi.

1.2. UBT:

- a) Ofron këshillim dhe mbështetje në hartimin e strategjive dhe politikave në fushën e kontrollit, kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale, duke u bazuar në hulumtimet akademike dhe praktikatat bashkëkohore.
- b) Ofron këshillim dhe mbështetje teknike në funksion të hartimit dhe përmirësimit të rregulloreve për monitorimin dhe standardizimin e proceseve, për kontrollin e bimës së *cannabis*-it në përputhje me udhëzimet e Agjencisë.
- c) Ofron ekspertizën dhe infrastrukturën në funksion të zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore, zhvillimore dhe inovative, apo trajnimin e stafit të agjencisë.
- d) Mundëson aksesin në infrastrukturën dhe pajisjet laboratorike të avancuara për kryerjen e analizave dhe testimeve shkencore.

2. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje, Palët marrin përsipër sa vijon:

- a) Të vënë në dispozicion mjediset që disponohen nga secila Palë, në funksion të organizimit të aktiviteteve të përbashkëta.
- b) Të vendosin në dispozicion rezultatet e studimeve dhe analizave që kryejnë Palët, në kuadër të projekteve kërkimore të përbashkëta.
- c) Të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për organizimin e aktiviteteve në interes të ndërsjelltë.
- d) Të bashkëpunojnë për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe të sigurojnë pjesëmarrjen në to apo në aktivitete që organizohen me kërkesë të njëres Palë, në përputhje me kapacitetet njerëzore e profesionale.
- e) Të respektojnë parimet e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike.

Neni 5

Personat e kontaktit

1. Palët caktojnë dhe i komunikojnë njëra-tjetrës një person si bashkëkoordinues, për mbajtjen e komunikimit midis tyre, shkëmbimin e informacionit dhe përgatitjeve të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshje.
2. Palët caktojnë grupet e përbashkëta të punës për hartimin dhe formalizimin e projekteve me interes shkencor dhe profesional.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave

1. Palët kanë të drejtë të kërkojnë që përmbajtja e kësaj Marrëveshje dhe të dhënat personale të pjesëmarrësve në aktivitetet e përbashkëta dhe të gjitha informacionet e shkëmbyera, të ruhen dhe trajtohen si konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Detyrimet e mësipërme për ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave, shtrihen edhe mbi nëpunësit e palëve, gjatë dhe pas përfundimit të Marrëveshjes.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet mes tyre me mirëkuptim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet përmes dialogut, secila Palë mund ti drejtohet Gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
3. Secila Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë, përmes një njoftimi paraprak me shkrim drejtuar Palës tjetër, duke parashtruar arsyet e tërheqjes.

Neni 8

Dispozita të fundit

1. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti të nënshkruar nga Palët.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe lidhet për një afat kohor të pacaktuar.
3. Marrëveshja përgatitet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, të hartuara nga palët në vullnet të lirë e të plotë, me të njëjtën përmbajtje dhe formë, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Agjenci dhe 2 (dy) në UBT.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË
KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Prof. Ass. Linda PUSTINA



**PËR UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË
TIRANËS**

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

